

Zëri i Gruas Kosovare

Përmbajtja

- 2 Tradita e shiritit të bardhe në Pejë
- 2 Delegacioni i RRGK-se në SHBA
- 2 Shenimet nga takimi i RRGK-se në Nentor
- 3 Anetaret e RRGK-se vazhdojnë avokimin
- 3 Shenimet nga takimi i RRGK-se në Shtator
- 4 Dera e Hapur organizon Panairin e Artizanateve
- 4 Pjesëmarrja e RRGK-se në konferencën në Bangkok

Njohtimet

Kuvendi Vjetor i RRGK-se...
.....3 dhjetor

Takimi i RRGK-se.....
.....ATRC, 11:00, 6 shkurt

Vizitoni faqen e re të
webfaqes se RRGK-se:
[www.womensnetwork.org!](http://www.womensnetwork.org)

Anetare të RRGK-se!
Na dergoni informacione për
aktivitetet e juaja që ti publi-
kojme në buletin dhe webfaqe!

RRJETI I GRUPEVE TË
GRAVE TË KOSOVËS



KOSOVA WOMENS
NETWORK

www.womensnetwork.org

Në ditëlindjen e saj, filloi të zbatohet Rezoluta 1325

Ky vit shënoi përvjetorin e pestë të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, të datës 13 Tetor. Kjo rezolutë e rëndësishme inkurajon një përfshirje më të gjërë të gruas në tentativat për zgjedhjen e konfliktëve dhe krijimin e paqes. Duke marrë parasysh se Kosovarët janë duke hyrë në negociata lidhur me statusin e tyre përfundimtar politik, kjo rezolutë ka rëndësi të madhe. Gratë kosovare po e shfrytëzojnë këtë rezolutë për të kërkuar respektimin e të drejtave të tyre ligjore dhe demokratike për pjesëmarrje në negociata, rezultati i të cilave do të ndikojë në të ardhmen e shoqërisë së tyre. Në disa muajt e fundit, diskutimet lidhur me këtë rezolutë kanë arritur tek shtëpitë e qytetarëve, përmes mediave gjithëkombëtare, si dhe tek bazat ushtarake të KFOR-it dhe trupat tjerë ndërkombëtar, përmes Amnesty International:

Medica sjell Rezolutën 1325 në vëmendje të publikut

Përgatitur nga Veprorë Shehu
Medica Kosova shënoi përvjetorin e rezolutës duke avokuar publikisht për pjesëmarrjen e gruas në tavolinën e negociatave të Kosovës për bisedimet mbi statusin final të Kosovës. Veprorë Shehu dhe Lindita Juniku-Pula nga partia politike ADK folën në televizionin publik të Kosovës, RTK, lidhur me rezolutën dhe instrumentet për arritjen e barazisë gjinore në të gjitha nivelet vendimmarrëse. Shehu gjithashtu informoi publikun lidhur me tentativat e RRGK, Lobit Kosovar të Gruas dhe grave tjera Kosovare lidhur me avokimin për implementimin e Rezolutës 1325 si tek Kombet e Bashkuara, ashtu edhe në nivelin lokal, posaçërisht sa u përket bisedimeve për statusin.

KFOR-i Suedez Zbaton Rezolutën 1325

KFOR-i suedez ftoi RRGK për të mësuar më shumë lidhur me

gratë aktiviste dhe punën e tyre në Kosovë. Përfaqësues nga bazat ushtarake suedeze, finlandeze, çeke, si dhe anëtarë të SHPK-së ishin prezent. Kjo ishte si rrjedhojë e një takimi preliminar mes KFOR-it suedez dhe Kvinna till Kvinna, me ç'rast përfaqësuesit e KFOR-it shprehën interesimin e tyre për t'u takuar me gratë aktiviste.

Në takimin e 22 nëntorit, Igballe Rogova foli në emër të RRGK-së lidhur me punën e grave në politikë dhe OJQ, para, gjatë dhe pas luftës. Ajo gjithashtu përshtroi gjendjen momentale politike, ekonomike dhe sociale të grave në Kosovë.

Përkundër faktit që u deshën gjashtë vite për të marrë një ftesë të tillë, RRGK mirëpret këtë iniciativë të KFOR-it suedez dhe Kvinna till Kvinna. RRGK fuqimisht inkurajon të gjitha forcat paqeruajtëse anembanë botës që të ndërmarrin hapa të ngjashëm për implementimin e Rezolutës 1325 të KSOKB.

Amnesty International përkrahë thirrjet e RRGK lidhur me implementimin e Rezolutës 1325

Në një deklaratë publike të dhënë më 31 tetor, Amnesty International ftoi 'palët përkatëse' të 'përfshijnë gratë dhe komunitetet minoritare në bisedimet për statusin përfundimtar'. Në mënyrë edhe më specifike ata paraqitën nevojën e përfshirjes së grave në grupet punuese të ekspertëve. Amnesty International iu referohej disa neneve specifike të rezolutës të cilat i prekjin çështjet me të cilat Kosova përballohet për momentin dhe negociatat:

"Amnesty International fton shtetet e OKB-së të përfshira në bisedime të sigurojnë zbatimin e



© Daniel Skoglund/Swedish Armed Forces

RRGK-ja takohet me KFOR-in Suedez me 22 Nentor.

Rezolutës 1325 dhe të garantojnë përfaqësimin e femrave në bisedime. Organizata gjithashtu kërkon përvetësimin e një perspektive gjinore, siç është caktuar me nenin 8 të Rezolutës, e cila, për shembull, do të 'përfshijë gratë në të gjithë mekanizmat e implementimit të marrëveshjeve të paqes' dhe të sigurojë "masa të cilat sigurojnë mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut për gratë dhe vajzat, posaçërisht ato që ndërlidhen me kushtetutën, sistemin e zgjedhjeve, policinë dhe gjyqësorin'. Veçanërisht, këto masa duhet të adresojnë mosndëshkimin e dhunës në bazë gjinore, përfshirë krimet e luftës, të kryera kundër femrave gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë."

Amnesty International më tej shprehë përkrahjen për thirrjet e mëparshme të RRGK lidhur me përfshirjen e gruas në procesin e statusit përfundimtar, dhe ndikimin që kjo ka lidhur me arritjen e zgjidhjes më të përmbytshme për të ardhmen e Kosovës:

<http://web.amnesty.org/library/index/ENGEUR700172005?open&of=ENG-YUG>

Shënime nga takimet e nëntorit

o RRGK përkujtoi anëtarët se të gjitha informatat lidhur me veprimtaritë e tyre duhet të dërgohen në mënyrë elektronike tek RRGK, për tu përfshirë në buletin informativ dhe ueb-faqe. o IREX ka filluar me përkrahje të OJQ-ve lokale përmes FDI, të cilët ofrojnë grante mes \$5000-\$20,000 dhe ATRC, të cilat ofrojnë trajnime të cilat përgatiten sipas nevojave të OJQ-ve. o Me përkrahjen nga World Learning, një delegacion i RRGK i përbërë prej 9 anëtarësh, vizitoi SHBA-të për dy jave, me ç' rast identifikuan ide të reja për avokim, posaçërisht në lidhje me votimin e femrave (faqen 2).

o Igballe Rogova përfaqësoi RRGK dhe paraqiti punën e rrjetit në konferencën 'Women's Global Strategies for the 21st Century conference', në New York. o Oda përkrahi grupet rome, askali dhe egjiptiane në krijimin e një grupi punues për avokimin e arsimimit të fëmijëve. o Në një konferencë të AWID, të mbajtur në Tailandë, delegacioni i grave kosovare paraqiti punën dhe pikëpamjet e veta lidhur me situatën në Kosovë. Delegacioni theksoi se statusi i papërcaktuar politik i Kosovës paraqet një pengesë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror (faqen 3).

o Dera e Hapur organizoi një panair të artizanateve (faqen 3). o Rrjeti i gruas nga Peja, Jeta, shënoi "Ditën ndërkombëtare kundër Dhunës kundër Gruas" më 25 nëntor, duke organizuar një debat televiziv lidhur me temën e dhunës ndaj gruas dhe duke ofruar një performansë nga grupet rinore të rajonit. (faqen 3). o Qendra Kosovare për Studime Gjinore vazhdoi aktivitetet për përpullimin e historisë së grave kosovare në shoqërinë civile; me ç' rast anëtarët e RRGK përpuluan dhe dërguan në OKB një raport lidhur me situatën e dhunës ndaj gruas në Kosovë (faqen 3); dhe përpuluan një raport lidhur me mundësitë e barabarta në punësim, i cili do t'i dërgohet Bashkimit Evropian (faqen 3).

www.womensnetwork.org

Dita kundër Dhunës kundër gruas: Qendra për mirëqenien e gruas vazhdon traditën

Përgatitur nga Lumnije Deqani

Java e shiritit të bardhë (21-25 nëntor) është shndërruar në një traditë vjetore për Qendrën për Mirëqenien e Gruas në Pejë, ku çdo vit paraqiten shumë qytetarë vullnetarë, të cilët prenë shirita të bardhë dhe përgatisin fletushka lidhur me Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës Kundër Gruas. Pastaj, më 25 nëntor, studentët ecin nëpër rrugë që shpijnë deri tek institucionet, bizneset private dhe organizatat vendore e ndërkombëtare të cilave u shpërndajnë fletushka të cilat përmbajnë informata lidhur me këtë ditë. Çdo vit ndryshon grupi i studentëve vullnetarë për shpërndarjen e shiritave. Këtë vit, studentët e shkollës së artit Odhise Paskali morën pjesë në këtë aktivitet.

Në një ndodhi tjetër të ndërlidhur me këtë të fundit, rrjeti lokal i gruas, i quajtur Jeta, bashkëpunoi me stacionin televiziv Dukagjini, për të organizuar më 25 nëntor një debat të emërtuar "Si t'u ndihmojmë viktimave të dhunës". Lidhur me këtë temë gjatë debatit folën përfaqësuesit e sistemit gjyqësor, Shkollës



Studentet duke vendosur kordelen e bardhe pjesetarit te TMK-se, organizuar nga Qendra per Mireqenien e Gruas ne Peje.

Policore të Kosovës, të qendrës së strehimit dhe të rrjetit lokal Jeta.

Më 2 dhjetor, rrjeti do të organizojë një takim tjetër, në të cilin do të ftojë institucionet vendore dhe ndërkombëtare të komunës së Pejës. Në këtë takim do të paraqiten aktivitetet e rrjetit lokal Jeta si dhe ligji mbi barazinë gji-

nore. Studentët të shkollës së artit Odhise Paskali do të kryejnë një performansë lidhur me temën 'dhuna ndaj gruas', përdërisht grupi i rinisë nga Istogu, Peja dhe Gjakova, i quajtur Global Motion, do të realizojë një pantomimë të shkurtë dhe një performansë interaktive lidhur me temën.

RRGK përforcon kapacitetet e avokimit në një udhëtim zyrtar në SHBA

Përmes programit trajnues 'World Learning Participant Training Program', të financuar nga USAID, një ekip 9-anëtarësh nga RRGK vizitoi grupet kryesore avokuese të grave Shtetet e Bashkuara, prej 17 shtator deri më 1 tetor. Ky udhëtim, i organizuar nga PeopleWork dhe 'Center for Women in Government and Civil Society (Albany)', kishte për qëllim ngritjen e aftësive të delegacionit për avokim dhe krijimin e mënyrave konkrete për përforcimin e bashkëpunimit me gratë në pozita udhëheqëse, si në sektorin e politikës ashtu edhe në atë privat.

Në një takim të rëndësishëm të organizuar në moment të fundit nga UNIFEM, pesë anëtarë të delegacionit të RRGK u takuan me zyrtarët më të lartë të Departamentit për Operacione Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara (DPKO), përfshirë ed-

he Zt. Wolfgang Weisbrod-Weber, Drejtor i DPKO për njësitë e Evropës dhe Amerikës Latine. Përfaqësueset e RRGK paraqitën brengat e tyre lidhur me mungesën e shtjellit të çështjeve gjinore në UNMIK dhe me pjesëmarrjen e gruas në bisedimet për statusin. Përveç marrëveshjeve për bashkëpunim në të ardhmen, përfaqësuesit e DPKO thanë se do të ndikojnë në agjendat e misioneve të nivelit të lartë, në mënyrë që në të ardhmen në to të parashihen edhe takime zyrtare me organizata të grave.

Grupet me të cilat delegacioni i RRGK është takuar gjatë vizitës përfshinë: në Washington, D.C. - me Emily's List, the National Women's Political Caucus and League of Women Voters; në Albany, New York, Governorin e shtetit New York, Znj. Mary O. Donahue, New York State Coalition Against Domestic Violence,

TV Station WNYT Channel 13, Equinox, The Legal Project, United Way Foundation, Global Democracy Programs, Women's Fund of Northeastern New York dhe me Center for Women in Government and Civil Society; dhe në New York City, National Council for Research on Women, the White House Project, Equality Now, Open Society Institute, Përfaqësuesen e shtetit të New York Znj. Deborah Glick, Women's Commission for Refugee Women and Children, UNIFEM, Fondacionin dhe Zyrën e Senatores së SHBA Znj. Hillary Clinton.

Delegacioni i RRGK kaloi një fundjavë me Organizatën Shqiptaro-Amerikane të Gruas Motrat Qiriaz gjatë takimit të quajtur "Empower Yourself" në Jeronimo Resort Center. Kjo paraqiti një mundësi të mirë të kombinimit të relaksimit dhe shërimit me zhvillimin profesional dhe personal.

RRGGK sjell çështjet e Kosovës në pragjet e vendimmarrësve vendor dhe ndërkombëtarë

Gjatë tre muajve të kaluar, anëtarët e RRGK kanë shprehur një aktivitet tejet aktiv për të sjellë brengat e qytetarëve të Kosovës tek vendimmarrësit vendorë dhe ndërkombëtarë.

Gjatë tetorit, Qendra Kosovare për Studime Gjinore në Prishtinë mësoi në momentin e fundit, nga partnerët e vet në rrjetin Ndall Dhunën Kundër Gruas, në Njësia e Kombeve të Bashkuara për avancimin e gruas ishte duke e ndërmarrë një studim global lidhur me dhunën kundër gruas dhe ishte duke kërkuar të dhëna nga OJQ-të lokale. Kur përfaqësuesit e Qendrës kuptuan se askush në Kosovë nuk ishte informuar lidhur me këtë studim, ata morën iniciativën për të përmbledhur një studim tre-ditor lidhur me situatën e dhunës ndaj gruas në Kosovë, të cilin do ta dorëzonin më 15 tetor, që ishte afati i fundit për dorëzim. Qendra kontaktoi anëtarët e RRGK të cilët janë të specializuar në çështjet e dhunës ndaj gruas dhe i informoi ata lidhur me këtë mundësi për të kontribuar në raportin e OKB-së që do të merret me këto çështje. Të gjithë pesë anëtarët e kontaktuar e pranuan sfidën, duke kryer intervista të cilat do të ndihmonin në përpilimin e raportit, me ç'rast u kontaktuan: Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, Liria, Qendra për

Mirëqenien e Gruas dhe strehimoret. Përmes punës ekipore dhe shfrytëzimit të resurseve të rrjetit, anëtarët e RRGK arritën të organizojnë dhe përpilojnë një raport të fuqishëm të cilin e dorëzuan drejtpërdrejt në Njësinë për Avancimin e Gruas të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në New York, i cili përmbante informata lidhur me disa nga shkaktarët e dhunës ndaj gruas në Kosovë; të dhëna nga përvojat e mira dhe të këqija të OJQ-ve që punojnë në këto çështje; dhe rekomandime lidhur me hapat e ardhshëm të cilët duhet të ndërmerren nga OKB, UNMIK, qeveria vendase dhe OJQ-të (shih www.womensnetwork.org për raport të plotë). Në këtë mënyrë, gratë Kosovare ngritën zërin në mënyrë që ai të dëgjohet nga vendimmarrësit në OKB.

Së dyti, RRGK morri pjesë në një grup këshillues për Shqyrtimin e Sektorit të Sigurisë së Brendshme (ISSR), më 10 nëntor. ISSR paraqet një proces me tetë etapa, i cili analizon nevojat afatshkurta dhe afatgjata për zhvillimin e sigurisë së brendshme në Kosovë, pas përcaktimit të statusit përfundimtar. Si pjesë e këtij grupi, RRGK do të punojë me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm për të informuar, shqyrtuar, dhe vlerësuar secilën pjesë të procesit të ISSR.

Së treti, RRGK ka vazhduar

takimet me liderë vendorë dhe ndërkombëtarë, për të mbledhur të dhëna për raportin e rrjetit mbi ekzaminimin e implementimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në bashkëpunim me UNIFEM dhe Kvinna till Kvinna. Kjo vazhdoi të ngrejë vetëdijen e liderëve lidhur me rezolutën, si dhe vazhdojë t'i inkurajojë ata që të implementojnë këtë rezolutë edhe më tej në Kosovë.

Në tentativën e katërt, Qendra Kosovare për Studime Gjinore po punon në përpilimin e një raporti tjetër si pjesë e Rrjetit të Evropës Qendrore dhe Lindore për Mundësi të Barabarta. Monitorimi i raportit ekzaminoi mundësitë e barabarta në vend të punës, sipas ligjit dhe në praktikë. Raporti përfshinte rekomandime për përmirësimin e legjislacionit të Kosovës si dhe praktikave ligjore sa i përket kësaj çështje. Instituti për Shoqëri të Hapur do të botojë këtë raport si pjesë e një studimi rajonal për vendet që do t'i shtohen BE-së dhe do t'ia dërgojë raportin përfundimtar Bashkimit Evropian më 2006.

Pas më shumë se pesë vitesh të avokimit intensiv, RRGK është duke arritur sukses në sjelljen e zërave të grave të Kosovës drejtpërdrejt tek vendimmarrësit. Urime, anëtarëve të RRGK, për këtë të arritur!

Rekomandimet për Qasje më të mirë ndaj dhunës kundër Gruas në Kosovë Fragment nga një studim i kryer nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore për OKB-në

Për Qeverinë e Kosovës:

o Të vazhdojë bashkëpunimi me gratë aktiviste dhe OJQ-të në përpilimin, miratimin, dhe më e rëndësishmja, në implementimin e legjislacionit që adreson dhunën kundër gruas.
o Institucionalizimi i strehimoreve dhe alkimi i fondeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për të shtuar hapësirën dhe përkrahjen ndaj viktimave. Mungesa e fondeve dhe hapësirës ka ndikuar në shkurtimin e kohës së mbajtjes së grave në strehim, e madje edhe në refuzimin e grave.
o Inkurajimi i i komunave për përkrahje më të madhe ndaj strehimoreve.
o Alokimi i fondeve dhe bashkëpunimi i forcave policore me strehimore, për të krijuar një sistem të mbrojtjes së dëshmitarëve.
o Bashkëpunimi me UNMIK-un për të krijuar një sistem përmes së cilit banoret e strehimores mund të përmbajnë veten financiarisht. Pasi që ato nuk mund të jenë financiarisht të pavarura, gratë shpesh ndodhë të detyrohen të kthehen

për të jetuar në rrethina të dhunshme.

Për Organizatën e Kombeve të Bashkuara:

o Të bëjë presion tek UNMIK-u për të nënshkruar legjislacionin e duhur i cili merret me dhunën ndaj grave. Edhe më me rëndësi është bashkëpunimi me qeveritë lokale për implementimin e legjislacionit që merret me dhunën ndaj gruas.
o Në pajtim me Rezolutën 1325 të KS të OKB-së, respektivisht me nenin 6, i cili kërkon nga forcat paqeruajtëse dhe përfaqësuesit e OKB-së të kalojnë trajnime të detajuara lidhur me parandalimin e dhunës ndaj gruas dhe trafikimit.
o Në pajtim me Rezolutën 1325 të KS të OKB-së, respektivisht me nenin 11, i cili parashihet rregulla më të ashpra për individët e punësuar në misionet e OKB-së, sipas të cilave ata do të përjetonin pasoja të rrepta nëse zbulohen duke marrë pjesë në trafikimin, keqtrajtimin apo në forma të ndryshme të dhunës ndaj femrave.
o Gjatë studimit të kësaj teme, të pu-

nohet drejtpërdrejt me institutet humluese të secilit vend, pasi që ata janë në dijeni me situatën lokale dhe mund të sigurojnë qasje të drejtpërdrejt në të dhënat relevante.

Për OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare:

o Të vazhdojnë përkrahjen dhe trajnimin e forcave lokale policore, gjykatësve, mediave dhe prokurorëve, në mënyrë që ata të mund të identifikojnë situatat e dhunshme, dhe të ofrojnë siguri dhe ndihmë për viktimat.

o Të shfrytëzojnë artin dhe kulturën, apo veglat tjera popullore të komunikimit, për t'ia përshkruar popullatës së gjërë më mirë mekanizmat ligjor kundër dhunës ndaj gruas.

o Përfshirjen e burrave dhe grave në programet të cilat merren me trauma si rezultat i konflikteve dhe luftës. Për të gjetur tërë tekstin drejtoheni në:

www.womensnetwork.org

Shënime të takimeve të shtatorit

o Kontrolloni paraqitjen e re të ueb-faqes së RRGK: www.womensnetwork.org!
o Pas intervistave me institucionet lokale, RRGK dhe UNIFEM janë duke e përgatitur një raport lidhur me shkallën e implementimit të Rezolutës 1325 të KS të OKB-së në Kosovë (shih faqen 3).

o Flora Macula nga UNIFEM e ka paraqitur Rezolutën 1325, duke sqaruar se shumë OJQ e zbatojnë atë në punën e tyre të përditshme, pa qenë të vetëdijshme për këtë fakt.

o Anëtarët e RRGK dhe përfaqësuesit e strehimoreve janë takuar me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

o Qendra e Gruas (Pejë) paraqiti projektin e tyre aktual "Parandalimi i trafikimit të genieve njerëzore - ngritja e vetëdijes duke informuar prindërit dhe fëmijët," përkrahur nga IOM.

o Gratë me aftësi të kufizuara (Prizren) me ndihmën e Zyrtarit për Çështje Gjinore të Prizrenit, kanë filluar me ndihmimin e grave me aftësi të kufizuara në marrjen e patent shoferit. Zyra Zvicerane në Kosovë e ka ndihmuar këtë projekt.

o Qendra për mbrojtjen e viktimave të trafikimit ka zhvilluar një projekt për integrimin e viktimave fëmijë të trafikimit, përmes trajnimeve dhe edukimit profesional.

o Qeliza (Gjakova) përshkruan projektet e veta: ekspozitën e kostumeve kombëtare dhe 'gratë rome mund t'i dalin në krye'.

o OJQ e re e grave në Deçan, Jeta, e cila ka aplikuar për anëtarësim në RRGK, është paraqitur.

Marrë nga artikulli i Evliana Beranit, i titulluar "Gratë, luftërat dhe revolucionet"

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

+381 (0)38 245 850

Agim Ramadani Nr. 50/8

Prishtinë, Kosovë

Stafi i RRGK

Igballe Rogova

Drejtoreshë Ekzekutive
igo@womensnetwork.org

Besa Shehu

Menaxhere e Financave
info@womensnetwork.org

Nexhmije Fetahu

Menaxhere e Programit
info@womensnetwork.org

Alba Loxha

Asistente e Informatave
info@womensnetwork.org

Bordi i RRGK

Naxhije Buçinca

Delina Fico

Luljeta Vuniqi

Marta Prekpalaj

Vjosa Dobruna

Belgjyza Muharremi

Behar Selimi

"Zëri i Grave Kosovare" është shkruar dhe dizajnuar nga Nicole Farnsworth, përveç në rastet të caktuara kur kjo është cekur.

www.womensnetwork.org

Më se 1800 pjesëmarrëse nga 120 vende të botës u mbledhën në Bangkok më 28 dhe 29 tetor për të diskutuar mbi temën "Si ndodhin ndryshimet?" në një konferencë të organizuar nga Shoqata për të Drejta të Gruas në Zhvillim (AWID). Pesë kosovare morën pjesë në këtë ngjarje: Igballe Rogova, Luljeta Vuniqi, Jehona Gjurgjeala, Nora Spahiu dhe Evliana Berani.

Në seancën e posaçme lidhur me rolin dhe reagimin e gruas në situata të konfliktit, Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RRGK, përshkroi si ndikon politika në Kosovë tek gratë: "Kosova nuk ka status [politik], dhe mungesa e statusit do të thotë mungesë e investimit, mungesa e investimeve do të thotë se nuk ka ekonomi, dhe një rajon pa ekonomi do të thotë ngritje në dhunën shtëpiake dhe në dhunën e gjithmbarshme ndaj gruas."

Sipas rezolutës 1325, hapi i parë i vendimmarrësve kur gjenden në një situatë post-konfliktuale do të duhej të ishte të konsultohen me OJQ të grave. Rogova theksoi se problemi dhe brenga më e madhe me të cilën

po përballen gratë e Kosovës është mungesa e dëshirës tek përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare për të konsultuar dhe dëgjuar zërat e grave. Ajo gjithashtu theksoi se në fushat e konflikteve si dhe në ato që gjenden në situatë post-konfliktuale, nuk mund të imagjinohet krijimi i një shoqërie të qëndrueshme sikurse edhe i rrjeteve të grave, pasi që të hollat u jepen atyre të cilëve u nevojiten më së shumti, ose atyre që mund t'i shfrytëzojnë të hollat për ndryshuar situatën.

Rogova ofroi dy rekomandime të cilat bashkësia ndërkombëtare do të duhej t'i ndjekë në fushat me konflikte apo në ato post-konfliktuale. Se pari, bashkësia ndërkombëtare duhet t'i konsultojë gratë lidhur me të gjitha çështjet e rëndësishme, dhe jo vetëm lidhur me ato



Igballe Rogova duke folur ne panel ne konferencen Nderkombetare AWID ne Bangkok.

çështje që kanë të bëjnë me gjini. Së dyti, donatorët duhet të përkrahin projekte afatgjata pasi që OJQ-të e grave nun mund të funksionojnë në mënyrë të duhur nëse e dinë se projekti apo fondet e tyre do të përfundojnë brenda dy-tre muajsh.

Në një seance tjetër, Luljeta Vuniqi, Drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore, dhe Jehona Gjurgjeala, autore, paraqitën botimin e qendrës të vitit 2005 "Si votojnë gratë kosovare?"

Dera e Hapur organizon panair

Nga Alba Loxha

OJQ Dera e Hapur organizoi Panairin e Artizanateve dhe Produkteve Bujqësore të Grave Kosovare, nga 21 deri më 23 tetor në Qendrën e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë. Panairi shënoi javën e luftës kundër varfërisë, një ngjarje kjo e cila u organizua mes 18 dhe 23 qershor. Disa anëtare të RGGK, të cilat kanë për qëllim zvogëlimin e varfërisë në Kosovë, u paraqitën në këtë ekspozitë.

Punimet e paraqitura përfshinin veshje tradicionale nga hapësira

të ndryshme, сувенире artistike, produkte ushqimore të përgatitura nga perimet vjeshtore, dhe ëmbëlsira të përgatitura nga pemët. Gratë prezantuan punët e tyre të dorës, që i shërbente dy qëllimeve. Së pari, ruante traditat e trashëguara të Kosovës. Së dyti, gratë vuajnë jo-proporcionalisht nga papunësia; sipas Riinvestit, në vitin 2003 64% të femrave dhe 40% të meshkujve ishin të papunë. Rrjedhimisht, panairi siguroi të hyra modeste për gratë të cilat i përkrahin fa-

miljet e tyre.

Ky panair gjithashtu demonstroi bashkëpunimin pozitiv mes OJQ-ve dhe qeverisë, pasi që pati përkrahje të Komunitetit të Prishtinës, Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Ky ishte panairi i dytë i tillë, që organizohet me përkrahje të RRGK dhe UNDP. Njerëz të shumtë e vizituan këtë panair, ngjarje kjo që u përcoll nga mediat elektronike të RTV21 dhe RTK.



Prodhimet e dorës të ngjajshme me keto ishin të ekspozuara për shitje në festivalin e artizanateve.